



Gazeta britanike “The Daily Star” ka bere protagonist te saj shqiptarin Adnan Januzaj. Ne qender te shkrimit te shtypit britanik ka qene interesimi i tofozeve shqiptare , te cilet i bejne thirrje futbollistit per te zgjedhur Shqiperine. Gazeta i ka quajtur tifozet “nacionalist” nje term ky paragjykues, duke thene se lojtari i Manchesterit, Januzaj eshte vene ne shenjester te nacionalisteve shqiptar qe duan te influencojne ne vendimin e tij per te luajtur me kombetaren e Shqiperise apo te Belgjikes, ku ka lindur. “The Daily Star” vijon duke theksuar se : “Per shkak te trashegimise se tij perzier, ylli i Mancshter United mund te luaje per Shqiperine, Belgjiken, Serbine dhe Turqine, por ende nuk ka vendosur. Ne postimet ne mediat sociale, atij i kujtohet se rrjedh nga gjak shqiptar dhe kete te mos e harroje”, shkruan gazeta angleze. Talenti me origjine shqipatre, 18 vjecari qe luan per Manchester United deri tani ka refuzuar qe te behet pjese e Kombetares Belge por akoma nuk ka zgjedhur ti thote po Shqiperise.